



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 106/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian”, nr.124, kundër debitorit Radio Kosova 1, me seli në Prishtinë, Sheshi “Nënë Tereza”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.542/18, të datës 02.02.2018, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 08.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Radio Kosova 1, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.542/18, i datës 02.02.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave ka caktuar urdhrin P.nr.542/18, të datës 02.02.2018, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.01543 të datës 31.01.2017, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Radio Kosova 1, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 5,600.00 € (pesë mijë e gjashtëqind euro) si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor me datën 20.12.2018, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbarimor nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Ka shtuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim është kopje, si dhe e njëjta nuk është vërtetuar konform dispozitës së nenit 37 të LPP-së, sepse fatura nuk është në origjinal dhe as kopje e vërtetuar, andaj nuk përbën dokument në bazë të cilit mund të lejohet përmbarimi. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe ka deklaruar se debitori ka për qëllim shtyrjen dhe prolongimin e pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit. Ka shtuar se fatura e lëshuar i plotëson të gjitha elementet e përcaktuara si dokument i besueshëm dhe lëndës i është bashkëngjitur edhe fatura origjinale ndërsa fatura e dorëzuar te debitori është e vulosur me vulën e saktësisë. Ka theksuar se urdhri për përmbarim është lejuar në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në LPP, dhe debitori nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën e argumenton se nuk e ka këtë borxh ndaj kreditorit dhe prapësimi nuk mbështetet në asnjërin nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të ngelet në fuqi, si i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura nr.01543, e datës 31.01.2017, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura nr.01543 të datës 31.01.2017, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se fatura është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura nuk përmban as kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm edhe për faktin se në propozimin për përmbarim nuk është përcaktuar fare afati i përmbushjes së detyrimit, siç parashihet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili përcakton se Propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë *“kërkesën që organi përmbarues ta detyrojë debitorin e përmbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara”*.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi

privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.106/22, datë 08.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.